

Familjarët e tre të vrarëve boshnjakë më 1995 në masakrën e Srebrenicës do të marrin kompensim pasi Holanda ra dakort për këtë.

Të afërmit e tre personave që u nxorën asokohe me forcë nga një ndërtesë e OKB-së fituan një betejë të gjatë me shtetin holandez. Ata pretendonin se jetët e Muhammed Nuhanoviç, të atit të tij, Ibros, dhe të Rizo Mustafiçit kishte qenë e mundur të shpëtoheshin.

Sipas një deklarate të Ministrisë holandeze të Mbrojtjes, ministrja Jeanine Hennis-Plasschaert kërkoi ndjesë për viktimat.

Ankimi që bërë nga të afërmit e Muhammed Nuhanoviçit, 27-vjeçarit që punonte si përkthyes për kontigjentin holandez të OKB-së.

Ende nuk është bërë e ditur shuma e kompensimit, por më herët u që ofruar familjeve të viktimave një shumë prej 20.000 eurosh.

Viktimat patën kërkuar mbrojtje të trupat holandeze, por u lanë në duart e serbo-boshnjakëve, të cilët më pas i ekzekutuan.

Në Bosnjë-Hercegovinë shërbyen si paqeruajtës mbi 2.000 ushtarë holandezë, por roli i tyre në atë mision është ende i mjegulluar, ndërsa ata më e pakta nuk bënë asgjë për të mbrojtur jetët e boshnjakëve.

Rreth 8.000 muslimanë u vranë në Srebrenica në korrik të vitit 1995 pasi qyteti u rrethua nga trupat serbo-boshnjake të komanduara nga Ratko Mlladiç. /tesheshi.com/